



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE (KQZ), në mbështetje të nenit 64, paragrafi 2, nënparagrafi 2.1 dhe 2.2, nenit 3, 101, 103, 104, 105 dhe 127 të Ligjit Nr.08/L228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LPZ), si dhe nenit 8, 20 dhe 29, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L- 072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës (LZL), me datën 22.03.2024, miraton këtë:

RREGULLORE ZGJEDHORE NR.16/2024

QENDRAT KOMUNALE TË NUMËRIMIT

Neni 1

Qëllimi

Kjo Rregullore përcakton themelimin, funksionimin, menaxhimin e Qendrave Komunale të Numërimit (QKN), mbikëqyrjen, pranimin, kontrollimin e materialit, verifikimin, numerimin dhe ankesat lidhur me procesin e punës në QKN.

Neni 2

Themelimi i Qendrave Komunale të Numërimit (QKN)

1. Zyrtari Ekzekutiv i Komisionit Komunal Zgjedhor (ZEKKZ), në bashkëpunim me komunën përkatëse, kujdeset që një herë në vit të bëjë identifikimin, analizën dhe vlerësimin e lokacionit dhe hapësirës për QKN.
2. KQZ, jo më vonë se pesë (5) ditë pas shpalljes së zgjedhjeve, njofton komunitat për lokacionet e rekomanduara për QKN.
3. KQZ, jo më vonë se pesë (5) ditë pas konfirmimit të lokacionit dhe hapësirës për QKN, nënshkruan memorandum bashkëpunimi me komunën përkatëse për shfrytëzimin e hapësirave dhe kushtet teknike.
4. Përrjashtimisht paragrafeve 2 dhe 3 të këtij neni, në rast se komuna nuk ka hapësira për QKN, ZEKKZ i propozon KQZ lokacione të tjera publike, apo në pamundësi të sigurimit të hapësirave publike, i rekomandon KQZ përdorimin e hapësirave private.

5. KQZ, merr vendim për themelimin dhe kohëzgjatjen e funksionimit të QKN.

Neni 3

Kriteret teknike

1. QKN caktohen në salla me përmasa të mëdha ose palestra sportive, që mundësojnë kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj.
2. Në përzgjedhjen e QKN duhet t'i jepet përparësi objekteve që kanë qasje të lehtë rrugore dhe janë afër Qendrave të Votimit (QV).
3. QKN duhet të plotësojë kriteret e domosdoshme, si në vijim:
 - 3.1. Kapacitet dhe hapësirë të mjaftueshme brenda;
 - 3.2. së paku një hyrje lehtësisht të qasshme;
 - 3.3. dalje emergjente;
 - 3.4. hapësirë të parkingut;
 - 3.5. energji elektrike;
 - 3.6. infrastrukturë hidrosanitare;
 - 3.7. rrjetin e internetit;
 - 3.8. sistemin e ngrohjes dhe ventilimit;
 - 3.9. pajisje kundër zjarrit;
 - 3.10. ndriçim të mjaftueshëm;
 - 3.11. inventarin.
3. Në rast të mungesës së rrjetit të internetit dhe inventarit të nevojshëm, KQZ është e obliguar të sigurojë të njëjtat si dhe pajisjet e nevojshme logjistike për procesin e numërimit të votave, në bashkëpunim me organet e tjera qendrore ose lokale, për periudhën e funksionimit të QKN.

Neni 4

Menaxhimi i QKN

1. KQZ rekruton staf për të mbështetur punën në QKN, harton skemën organizative për funksionimin e QKN dhe mbikëqyr zbatimin e aktiviteteve që zhvillohen në QKN.
2. KQZ, me vendim, përcakton numrin e ekipeve të numërimit dhe numrin e anëtarëve brenda ekipeve të numërimit, sipas specifikave të komunave përkatëse.

3. Punën në QKN e drejton KKZ. Menaxher i QKN-së është udhëheqësi i KKZ.
4. Detyrat dhe përgjegjësitë e KKZ në QKN, janë:
 - 4.1. Pranimi dhe dorëzimi i materialeve zgjedhore;
 - 4.2. sigurimi i mbarëvajtjes së punës;
 - 4.3. miratimi i orarit të numërimit të fletëvotimeve nga vendvotimet (VV);
 - 4.4. dërgimi i rezultateve nga QKN për tabulim në QNR;
 - 4.5. skanimi i formularëve të rezultateve dhe publikimi i tyre në vendet e qasshme për vëzhguesit si dhe ofrimi i tyre për subjektet politike dhe kandidatëve, sipas kërkesës;
 - 4.6. përgatitja dhe publikimi i rezultateve preliminare të kandidatëve;
 - 4.7. sigurimi i qasjes së vëzhguesve në secilin proces;
 - 4.8. zëvendësimi i anëtarëve të ekipeve të numërimit;
 - 4.9. raportimi në baza ditore në KQZ;
 - 4.10. përgatitja e rekomandimeve për KQZ.
5. Detyrat dhe përgjegjësitë e menaxherit të QKN, janë:
 - 5.1. Zbatimi vendimeve të KQZ dhe KKZ;
 - 5.2. udhëheqja e punës ditore në QKN;
 - 5.3. mbajtja e evidencës së punës të stafit të angazhuar në QKN;
 - 5.4. mbajtja e evidencës së punës për anëtarët e ekipeve të numërimit;
 - 5.5. përgatitja e raporteve ditore për KQZ dhe KKZ ;
 - 5.6. përgatitja e orarit të transportimit të materialit;
 - 5.7. mbajtja e evidencës për pranimin dhe dorëzimin e materialeve.
6. Përveç detyrave të cekura në paragrafin 4 dhe 5 të këtij neni, KQZ sipas nevojës mund të caktojë edhe detyra tjera.

Neni 5

Funksionet e QKN

1. QKN kryen këto funksione:
 - 1.1. Shërben si depo komunale e materialit zgjedhor;

- 1.2. shërben si hapësirë për trajnimin e trupave menaxhuese zgjedhore;
- 1.3. bën verifikimin e votave të subjekteve politike;
- 1.4. numërimin e fletëvotimet dhe votave të kandidatëve të subjekteve politike;
- 1.5. grumbullimin dhe publikimin e rezultateve preliminare të votave të kandidatëve.

Neni 6

Orari i punës

1. KKZ miraton dhe publikon një orar të numërimit në QKN për secilin VV.
2. Numërimi fillon në orën 08:00, mëngjesin e ditës së nesërme, pas ditës së zgjedhjeve.
3. Numërimi në QKN bëhet në dy ndërrime, 08:00 – 16:00 dhe 16:00 – 24:00.

Neni 7

Përgatitja e hapësirës

1. Para hapjes së QKN, me qëllim të fillimit dhe mbarëvajtjes së procesit të numërimit të votave të kandidatëve, KQZ bashkë me KKZ përgatit infrastrukturën e nevojshme logjistike të vendit të numërimit.
2. KQZ përgatitë skemë organizative të funksionimit për secilën QKN.
3. KQZ përcakton me vendim numrin e tavolinave të numërimit për çdo QKN, varësisht nga numri i VV në komunën përkatëse.

Neni 8

Regjistrimi i ambienteve të QKN me kamera të sigurisë

1. Në çdo QKN, instalohen kamera vëzhguese, që mbulojnë gjithë hapësirën e sallës në QKN, hyrjen, vendet ku bëhet pranimi dhe ruhen materialet zgjedhore.
2. Kamera gjatë gjithë kohës duhet të regjistrojë të gjithë hapësirën, pavarësisht nga orientimi i kërkuar në momente të caktuara dhe të mundësojë video regjistrimin.
3. Procesi i regjistrimit në të gjitha QKN, duhet të ketë pavarësi nga energjia elektrike për së paku 2 (dy) orë, në rast të ndërprerjes së energjisë elektrike.

Neni 9

Pranimi dhe dorëzimi i materialit zgjedhor nga KKZ

1. Procesi dhe dorëzimi i materialit zgjedhor nga KKZ, bëhet si në vijim:
 - 1.1. Pranimi dhe kontrollimi i materialit nga depo qendrore e KQZ, bëhet në secilën QKN – Shtojca I - Formulari i pranim – dorëzimit të materialit zgjedhor nga depoja qendrore në QKN;
 - 1.2. kthimi i materialit zgjedhor nga VV në QKN;
 - 1.3. dorëzimi i materialit zgjedhor nga QKN në QNR.
2. KKZ obligohet që secilin material zgjedhor që e pranon dhe dorëzon, ta bëjë në përputhje me procedurat e miratuara nga KQZ.

Neni 10

Ndarja e hapësirave për pranim dhe numërim

1. Secila QKN ndanë një hapsirë për pranimin e kutive të votimit, selektimin dhe sistemimin e tyre sipas QV dhe VV.
2. Secila QKN ndanë një hapsirë për procesin e numërimit për ekipet e numërimit, numri i të cilave varet nga numri i VV në komunën përkatëse.
3. Tavolinat e ekipeve të numërimit dhe vendi i anëtarëve të KKZ, duhet të jenë në të njëjtën sallë ku kryhet procesi i numërimit të votave.

Neni 11

Klasifikimi dhe sistemimi i materialit

1. KKZ, gjatë procesit të punës në QKN, pas pranimit dhe regjistrimit të materialit zgjedhor, nga depoja qendrore e KQZ-së bën klasifikimin dhe sistemimin e materialve, si në vijim:
 - 1.1. materialet sipas QV dhe VV;
 - 1.2. materilet e VV me kusht;
 - 1.3. materialet e votimit të Personave me Nevoja dhe Rrethana të Veçanta (VPNV).

Neni 12

Pranim dorëzimi i materialit nga KVV dhe Menaxherët e QV

1. Një ditë para hapjes së VV, por jo më vonë se ora 12:00, KVV bënë pranimin e materialeve jo të ndjeshëm për VV nga QKN - Shtojca – II - Formulari i pranim - dorëzimit i materialit jo të ndjeshëm zgjedhor nga KVV.
2. Një ditë para hapjes së VV, KKZ mbanë takim informues me menaxherët e QV dhe shpërndanë materialin jo të ndjeshëm për QV - shtojca – III - Lista pjesëmarrësëve të menaxherëve të QV dhe shtojca – IV - Formulari i pranim - dorëzimit të materialit jo të ndjeshëm zgjedhor nga menaxherët e QV.
3. KKZ sigurohet që më së voni deri në ora 06:00, të ditës së zgjedhjeve, të bëjë dorëzimin e materialit të ndjeshëm zgjedhor te KVV. Dorëzimi i materialit bëhet në hapësirat e QKN, shtojca - VII Formulari i pranim-dorëzimit të materialit të ndjeshëm nga QKN në KVV, sipas Rregullores Zgjedhore Nr.12/2024, Votimi, Numërimi dhe Menaxhimi i Vendvotimit.

Neni 13

Pranimi dhe regjistrimi i materialit nga KVV

1. Gjatë procesit të dorëzim–pranimit të materialeve zgjedhore nga VV në QKN, anëtarët e KKZ, veprojnë si në vijim:
 - 1.1. Shënojnë në procesverbalin e dorëzim–pranimit - Shtojca V - Formulari i pranim – dorëzimit të materialit zgjedhor nga KVV në QKN, numrat e shiritave të sigurisë, me të cilat është mbyllur kutia e votimit;
 - 1.2. verifikojnë përputhjen e numrave të shiritave të sigurisë të votimit si dhe materialet e ndjeshme për VV sipas procedurës së pranim-dorëzimit;
 - 1.3. në rast të mospërputhjes së shiritave mbyllës, KKZ konstaton mospërputhjen, e evidenton menjëherë në procesverbalin e dorëzim–pranimit, bashkë me sqarimin nga kryesuesi i KVV përkatëse.
 - 1.4. në rast se konstatohet mungesë ose paketimi i parregullt i materialit të ndjeshëm, KKZ në prani të kryesuesit të KVV e hapë kutin e votimit, paketon materialin sipas procedurave dhe e evidenton ndërrimin e shiritave të kutisë së votimit në procesverbalin e pranim–dorëzimit.
 - 1.5. nëse paketimi i sërishëm i materialeve është i nevojshëm, KKZ e mbyllë kutinë në prani të kryesuesit të KVV dhe shënon numrin/at e ri të shiritit mbyllës në FPR përkatëse, me

laps me ngjyrë të kuqe. Krahas këtyre ndryshimeve, anëtari i KKZ shënon numrin e vet identifikues të KQZ dhe inicialet e veta.

2. Procesverbali i dorëzim–pranimit përgatitet nga KQZ në formën e një formulari që duhet të përmbajë: kohën e dorëzim–pranimit, numrin e QV, të VV, vulave me shiritat e sigurisë të kutisë së mbyllur, hapësirën për përshkrimin e mospërputhjeve ose parregullësive të konstatuara, hapësirën për materialet që mungojnë si dhe hapësirën për nënshkrimet.
3. Formulari i pranimit–dorëzimit i bashkangjitet FPR, librit të votimit dhe listës votuese.

Neni 14

Verifikimi i rezultateve preliminare me FPR

1. Pas publikimit të rezultateve preliminare nga VV, KKZ bën kontrollimin e rezultateve të publikuara, duke i krahasuar me të dhënat që QKN i proceson nga kopjet e Formularëve të Përputhjes së të Dhënave dhe Rezultateve (FPR).
2. Subjektet politike dhe kandidatët mund të kërkojnë nga KKZ, verifikim të rezultatit të publikuar në platformën elektronike, duke i krahasuar me formularët e rezultateve.
3. KQZ bën korrigjimin e rezultateve preliminare, sipas njoftimit për korrigjim të pranuar nga KKZ përmes ZEKKZ.

Neni 15

Numërimi i fletëvotimeve në QKN

1. KQZ obligohet të garantojë transparencë të plotë të numërimit të votave në QKN, duke përfshirë mundësinë e përdorimit të teknologjisë në monitorimin, leximin apo skanimin e materialeve.
2. Gjatë procesit të verifikimit dhe numërimit vlejnë procedurat e numërimit në VV, sipas Rregullores Zgjedhore Nr.12/2024 Votimi, numërimi në vendvotim dhe menaxhimi i vendvotimit.
3. Vota për kandidat numërohet nëse në fletëvotim janë të shënjuar një deri në dhjetë kandidatë. Në rast se janë shënjuar më shumë se 10 kandidatë apo nuk është shënjuar asnjë kandidatë, atëherë numërohet vetëm vota e subjektit politik.

Neni 16

Numërimi i fletëvotimeve përmes pajisjeve dhe softuerit

1. Në rast të përdorimit të teknologjisë për leximin apo skanimin e materialeve, hapat e procesit të numërimit të fletëvotimeve në mënyrë elektronike janë:

- 1.1. Fletëvotimet duhet të vendosen në pozitën e duhur për të siguruar lexim të saktë. Mund të ketë nevojë për të rregulluar fletëvotimet në një rend të caktuar për të mundësuar leximin e tyre nga pajisja;
 - 1.2. fletëvotimet ngarkohen në skaner ose pajisje të ngjashme, të cilat kanë teknologji të specializuara për të skanuar dhe lexuar fletëvotimet;
 - 1.3. pajisja skanon fletëvotimet, duke identifikuar preferencat e votuese dhe informacionin tjetër që gjendet në to;
 - 1.4. pas skanimit, pajisja e lexon informacionin nga fletëvotimet, i shëndërron në format digjital dhe prezanton rezultatin e subjekteve dhe kandidatëve për secilin VV.
 - 1.5. në rastet kur fletëvotimi është i pa lexueshëm nga pajisja, anëtarët e ekipit të numërimit bëjnë verifikimin dhe vlerësimin e fletëvotimit.
2. Pas përfundimit të procesit të numërimit të fletëvotimeve, ekipi i numërimit bëjnë një kontroll të rastësishëm të rezultateve, për të siguruar saktësinë e informacionit të regjistruar.
 3. KQZ me vendim miraton rregullat procedurale për procesin e numërimit të fletëvotimeve përmes pajisjeve dhe softuerit.

Neni 17

Teknologjia mbështetëse gjatë numërimit në QKN

1. Teknologjia mbështetëse mund të instalohet në çdo QKN. Çdo tavolinë numërimi është e pajisur me sistemin e teknologjisë mbështetëse përkatëse, që mundësojnë regjistrimin e procesit të numërimit dhe ofron pamje për vëzhguesit.
2. Ekipi i numërimit ka detyrimin të ekspozojë çdo fletëvotim në kamera, sipas procedurave të parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni.
3. Me qëllim të leximit të rezultateve, KQZ mund të vendosë të përdorë sisteme të Teknologjisë Informative Zgjedhore - TIZ, që mundëson leximin elektronik të të dhënave për secilin VV.
4. KKZ kujdeset për ruajtjen nga dëmtimet e jashtme të kësaj teknologjie, nga momenti i fillimit të procesit të numërimit të votave deri në përfundim të punës në QKN.

Neni 18

Procedura pas numërimit të fletëvotimeve dhe mbylljes së kutive të votimit

1. Pas mbylljes së kutisë së votimit, rezultatet dhe formularët skanohen dhe publikohen në uebfaqen e KQZ, vendosen në vende të qasshme në QKN për vëzhguesit dhe ju ofrohen subjekteve politike dhe kandidatëve, sipas kërkesës.

2. Të dhënat dhe rezultatet për çdo VV dërgohen për tabulim në QNR, menjëherë pas përfundimit të numërimit të kutisë së votimit.
3. Pas përfundimit të gjithë procesit të numërimit të votave të kandidatëve në QKN, materialet zgjedhore dorëzohen në QNR.

Neni 19

Gjenerimi dhe publikimi i rezultateve

1. Publikimi i rezultateve preliminare nga QKN, përfshin:
 - 1.1. Rezultatet e përditësuara të subjekteve politike për zgjedhjet për Kuvend të Kosovës dhe Kuvend Komunal, pas verifikimit;
 - 1.2. rezultatet e përditësuara të kandidatëve për Kryetar Komune;
 - 1.3. rezultatet e kandidatëve të subjekteve politike.
2. Paraqitja e rezultateve bëhet në pajtim me këtë Rregullore si dhe Rregulloren Zgjedhore Nr. 13/2024 Rezultatet Zgjedhore.
3. Rezultatet e gjeneruara nga QKN konsiderohen përfundimtare pas verifikimit nga QNR

Neni 20

Ekipet e numërimit

1. KQZ, me vendim, përcakton numrin e ekipeve të numërimit dhe numrin e anëtarëve brenda ekipeve të numërimit, sipas specifikave të komunave përkatëse.
1. Përbërja e përgjithshme e ekipeve të numërimit, reflekton përfaqësimin në KKZ, për aq sa është e mundur.
2. Kryesuesit e ekipeve të numërimit, zgjedhen në mënyrë të barabartë nga katër subjektet e para që kanë fituar numrin më të madh të votave për Kuvendin e Kosovës gjatë zgjedhjeve të fundit në atë komunë dhe janë certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhjet aktuale.
3. Caktimi i kryesuesve të ekipit të numërimit, sipas paragrafit 3 të këtij neni, bëhet përmes formulës së rotacionit të cilën e zbaton KKZ, sipas renditjes së votave që kanë fituar në zgjedhje.
4. Procedura e nominimit dhe emërimit të ekipeve të numërimit bëhet në pajtim me procedurat e përcaktuara në Rregulloren Nr. 11/2024 Këshillat e Vendvotimeve.
5. Ekipet e numërimit fillojnë punën një ditë pas ditës së zgjedhjeve, jo me vonë se ora tetë (08:00). Procesit të numërimit zhvillohet në dy (2) ndërrime.

6. Ekipe të numërimit paguhen për aq ditë sa punojnë.

Neni 21

Përgjegjësitë e ekipit të numërimit

1. Kryesuesi i ekipit të numërimit është përgjegjës për organizimin, menaxhimin dhe mbarëvajtjen e numërimit.
2. Ekipi i numërimit kryen detyra të përcaktuara sipas procedurës për verifikim dhe numërim në QKN, shtojca Nr – VI - Procedura për verifikim dhe numërim në QKN.
3. Asnjë anëtar i ekipit të numërimit nuk mund të numërojë dhe plotësojë votat e subjektit të vet.
4. Ekipi i numërimit obligohet të bëjë numërimin e fletëvotimeve në mënyrë transparente.
5. Ekipi i numërimit është përgjegjës për plotësimin e formularëve të rezultateve dhe saktësinë e tyre.
6. Pas përfundimit të numërimit, ekipi i numërimit kthen të gjitha fletëvotimet e atij VV në kuti të votimit dhe mbyllë kutinë e votimit.
7. Anëtarët e ekipit të numërimit shënojnë në formular të rezultateve numrat e shiritave mbyllës të kutisë së votimit dhe nënshkruhen në formular të rezultateve, të krijuara nga ekipi i numërimit.
8. Ekipi i numërimit dorëzon kutinë e mbyllur të votimit me material zgjedhor tek KKZ.

Neni 22

Garantimi i transparencës së numërimit në QKN

1. Me qëllim të garantimit të transparencës së numërimit, procesi i punës në secilën tavolinë të numërimit paraqitet në mënyrë të qartë dhe të qasshme për vëzhguesit në QKN.
2. KQZ siguron pamje të fletëvotimeve nga secila tavolinë e numërimit për vëzhguesit në QKN, në mënyrë që të shihet qartë secili fletëvotim.
3. Procesi i numërimit të votave nga secila tavolinë e numërimit do të transmetohet në një monitor (ekran), të vendosur përballë vëzhguesve të subjekteve politike.
4. Në çdo imazh të transmetuar dhe të regjistruar, evidentohet numri i tavolinës në të cilën numërohen votat dhe numri i VV.

5. Në imazhet e fletëvotimeve që prezantohen në ekrane para vëzhguesve, secili imazh i fletëvotimit duhet të ketë një kod, i cili përbëhet nga kodi i VV dhe një numër rendor i rastësishëm.
6. Të gjitha imazhet e regjistruara të fletëvotimeve ruhen në format digjital, të cilat identifikohen në bazë të kodit sipas kësaj rregullore.

Neni 23

Paketimi i materialit dhe dërgimi në QNR

1. Paketimi i materialit në QKN nga të gjitha VV, bëhet në përputhje me procedurat e paketimit në VV.
2. Pas procesit të numërimit të të gjitha VV të komunës përkatëse, materiali dërgohet në QNR - Shtojca – VII - Formulari i pranim - dorëzimit të materialit zgjedhor në QNR.

Neni 24

Ankesat për procesin në QKN

1. Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN, bëhen në pajtim me nenin 105 të LZP, sipas procedurave të PZAP, brenda dyzetetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar.
2. Paraqitja e ankesës nuk e ndërpret procesin e numërimit.

Neni 25

Mbyllja e QKN

1. Pas përfundimit të të gjitha procedurave të numërimit, paketimit dhe dërgimit të materialit në QNR, KKZ vepron si në vijim:
 - 1.1. Kthen objektin në gjendjen e mëparshme;
 - 1.2. bën dorëzim–pranimin e objektit;
 - 1.3. përgatitë raport për punën e QKN dhe dorëzon në KQZ.
 - 1.4. evidenton dhe dorëzon në depon kryesore të gjitha pajisjet dhe materialet që ka qenë e ngarkuar.

Neni 26

Dispozita kalimtare dhe përfundimtare

1. KQZ harton procedura të veçanta që rregullojnë në mënyrë të detajuar të gjitha proceset në QKN brenda periudhës nëntëdhjetë (90) ditore.
2. Pjesë përbërëse të kësaj Rregullore janë:
 - 2.1. Shtojca I - Formulari i pranim – dorëzimit të materialit zgjedhor nga depoja qendrore në QKN;
 - 2.2. shtojca – II- Formulari i pranim - dorëzimit të materialit jo të ndjeshëm zgjedhor nga KVV;
 - 2.3. shtojca – III - Lista pjesëmarrësëve të menaxherëve të QV;
 - 2.4. shtojca – IV - Formulari i pranim - dorëzimit të materialit jo të ndjeshëm zgjedhor nga menaxherët e QV;
 - 2.5. shtojca – V - Formulari i pranim – dorëzimit të materialit zgjedhor nga KVV në QKN;
 - 2.6. shtojca - VI - Procedura për verifikim dhe numërim në QKN;
 - 2.7. shtojca VII - Formulari i pranim - dorëzimit të materialit zgjedhor në QNR.

Neni 27

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit.

Kryesues

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi